

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

Arsimi muzikor

për klasën I

Shkup, 2021

TË DHËNAT ELEMENTARE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	<i>Arsimi muzikor</i>
Lloji/ kategoria e lëndës mësimore	I detyrueshëm
Klasa	I (e parë)
Temat mësimore në programin mësimor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dëgjojmë muzikë 2. Këndojmë, performojmë dhe kërcëjmë
Numri i orëve	1 orë në javë/ 36 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<p>Klasë (kabinet) e specializuar, e cila përveç mjeteve standarde dhe ndihmëse është e pajisur edhe me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • instrumente ritmike për fëmijë (daulle në madhësi të ndryshme, goditje, shkopinj ritmik, kastana, gong, cembale, ksilofon, trekëndësh, maraka, dajre); • burime të ndryshme të të mësuarit nga natyra dhe mjedisi i afërt - fletë letre me ngjyra, gjethe të thata nga pemët, shufra druri ose metali, qelqi, sende druri, metali me një larmi tingujsh në klasë); • materiale të shtypura (doracakë, revista, gazeta); • printime dydimensionale - të paplanifikuara (fotografi, ilustrime, postera etj.); • pajisje për riprodhues të audio dhe video incizimeve (CD dhe DVD player, pajisje Hi-Fi, televizor, kompjuter me qasje në internet, altoparlantë, projektor LCD, tabelë të mençur); • piano/ piano elektrike ose ndonjë instrument tjetër muzikor; • audio dhe video incizime: CD audio dhe video me përmbajtje të përshtatshme.
Normativi i kuadrit mësimor	<p>Puna edukativo-arsimore në klasën e parë mund të kryhet nga një person që ka titullin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - profesor i mësimit klasor, VII/ 1 ose VI/ 1 (sipas KMK-së) dhe 240 SETK; - profesor i arsimit parashkollor, VII/ 1 ose VI/ 1 (sipas KMK-së) dhe 240 SETK; - pedagog i diplomuar, VII / 1 ose VI / 1 (sipas KMK-së) dhe 240 SETK.

LIDHSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet e të mësuarit të paraqitura në programin mësimor shpiejnë drejt marrjes së kompetencave vijuese të përfshira në fushën **“Shprehja artistike dhe kultura”** nga standardet kombëtare:

<i>Nxënësi/ nxënësjë di dhe/ ose mund:</i>	
VIII-A.1	të manifestojë njohuri të formave të ndryshme të shprehjes artistike nga të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë dhe dizajn);
VIII-A.3	t’i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet individuale duke përdorur forma artistike ose forma të tjera të shprehjes krijuese (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	t’i interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në produkte artistike të krijuara nga të tjerët që i përkasin kulturave të tyre ose kulturave të tjera;
VIII-A.5	të manifestojë njohuri për kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj përmes letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, objekteve dhe produkteve të tjera kulturore;
VIII-A.6	t’i identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e tij/saj më të ngushtë dhe më të gjerë dhe për të analizuar lidhjen dhe ndërvarësinë e tyre.
<i>Nxënësi/nxënësjë pranon se:</i>	
VIII-B.2	qëndrimi kritik ndaj produkteve të ndryshme të artit është i rëndësishëm për zhvillimin e vlerave estetike individuale dhe shoqërore.

Programi mësimor përfshin kompetencat përkatëse në fushat e mëposhtme të standardeve kombëtare:

“Shkrim-leximi digjital”, “Zhvillimi personal dhe social” dhe “Shoqëria dhe kultura demokratike”.

<i>Nxënësi/ nxënësjë di dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyre për zgjidhjen e një detyre/ problemi është i nevojshëm dhe efektiv përdorimi i TIK-ut;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet atij/asaj , të gjejë, të zgjedhë dhe të shkarkojë të dhëna digjitale, informacione dhe përmbajtje;
V-A.4	t’i vlerësojë aftësitë dhe arritjet e tij/ saj (përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe mbi atë bazë të përcaktojë përparësitë që do të mundësojnë zhvillimin dhe përparimin e tij/ saj;
V-A.6	të vendosë qëllime për mësim dhe vetëzhvillimin dhe të punojë për të tejkaluar sfidat që dalin gjatë rrugëtimit drejt arritjeve të tyre;

V-A.7	t'i përdorë përvojat e veta për të lehtësuar mësimin dhe për të rregulluar sjelljen personale në të ardhmen;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në një mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informatë kthyesë dhe mbështetje për veten, por gjithashtu ta kthejë informatën në mënyrë konstruktive dhe mbështetëse në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të propozojë, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat në mënyrë që të nxjerrë konkluzione dhe të marrë vendime racionale;
VI-A.5	t'i kuptojë ndryshimet midis njerëzve për çfarëdo baze (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi shoqëror etj.);
VI-A.6	ta njohë praninë e stereotipave dhe paragjyqimeve të vetja dhe të tjerët dhe të kundërshtojë diskriminimin.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon që:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme. Lehtëson të mësuarit, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia personale kryesisht varen nga puna që ai/ajo investon dhe rezultatet që ai/ajo arrin;
V-B.4	çdo veprim që ai/ajo ndërmerr ka pasojë për të dhe/ose për mjedisin e tij/saj;
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja dhe përgjegjësi janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	bashkëveprimi me të tjerët është i dyanshëm. Siç ka të drejtë të kërkojë nga të tjerët që t'ia mundësojnë atij/asaj që të jetë i kënaqur me interesat dhe nevojat e tij/ saj, ashtu edhe ai/ ajo ka përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e veta;
V-B.9	kërkimi i informatave kthyesë dhe pranimi i kritikës konstruktive shpiejnë në përparim personal në nivel individual dhe shoqëror.

REZULTATET NGA MËSIMI

<p>Tema: DËGJOJMË MUZIKË</p> <p>Numri i përgjithshëm i orëve: 18</p>	
<p>Rezultatet nga mësimi</p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/ e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> dallojë zhurmën, tingullin, zërin dhe tonin nga natyra dhe mjedisi dhe ta shprehë përvojën, përjetimet e veta të zhurmave, tingujve, zërave të këndshëm dhe të pakëndshëm nga natyra dhe mjedisi; dallojë muzikën për fëmijë, muzikën popullore, muzikën e filmave të animuara dhe të njohë disa nga secili lloj; dallojë dhe zbatojë mjetet e duhura elementare muzikore shprehëse në muzikën e dëgjuar (temp, dinamikë, metër, lartësi, melodi, ritëm). 	
Përmbajtjet (dhe konceptet)	Standardet për vlerësim
<ul style="list-style-type: none"> Tingujt (tingulli, zhurma, zëri, toni). 	<ul style="list-style-type: none"> Njeh zhurmën, tingullin, zërin nga natyra dhe mjedisi. Bën dallimin midis tingujve dhe toneve.
<ul style="list-style-type: none"> Llojet e muzikës (muzikë klasike, muzikë për fëmijë, muzikë nga filmi i animuar, muzikë popullore, këngë festive - himni). 	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon llojin e muzikës që e dëgjon. Identifikon dhe rendit të paktën një kompozicion nga secili lloj i muzikës. Njeh himnin e shtetit.
<ul style="list-style-type: none"> Mjetet muzikore të shprehjes (melodia, ritmi, metri, i ngadaltë/ i shpejtë, tone të larta/të ulëta, me zë të lartë/ të qetë). 	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon kontrastet dëgjimore (të larta/të ulëta, të shkurtra/të gjata, të ngadalta/të shpejta, me zë të lartë/të qetë). Identifikon vokalen (në këndim), instrumentalen (në performim) dhe vokalo-instrumentalen (në këndim dhe performim). Identifikon karakterin e muzikës së dëgjuar (pikëlluese, ninulla, të hareshme, argëtuese, frikësuese).
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> Mësimdhënësi prodhon zhurma dhe tinguj të ndryshëm (trokitje, kërcitje, shushurimë), ndërsa nxënësit i njohin dhe i klasifikojnë ato (tinguj, zhurma, të këndshme, të pakëndshme). Mësimdhënësi prezanton tinguj nga natyra përmes audio incizimeve (të kafshëve, të shiut, të lumit), ndërsa nxënësit i njohin ose i imitojnë ato. Ky aktivitet, varësisht nga kushtet e motit, mund të realizohet edhe jashtë në oborr ose në mjedis. 	

- Mësimdhënësi lexon një tregim, ndërsa nxënësit ndjekin disa fjalë dhe krijojnë zhurma dhe tinguj të përshtatshëm që asocojnë me fjalën.
- Nxënësit, në grupe, i përgjigjen një kuizi në formë elektronike, në një tabelë inteligjente me programe ndërvepruese me temën “*Tingujt*” (përgatisin se për çfarë tingulli bëhet fjalë). Nëse nuk ka kushte për këtë, mund të përgjigjen duke ngritur letra me simbolin e përgjigjes së saktë.
- Mësimdhënësi iu prezanton nxënësve incizime audio të muzikës vokale, instrumentale dhe vokalo-instrumentale, ndërsa nxënësit përcaktojnë përmes ngjyrës së tonit nëse janë duke dëgjuar një zë, një instrument ose të dy elementët janë të pranishëm (muzikë vokalo-instrumentale).
- Mësimdhënësi këndon/perforon ose prezanton incizime audio të shkurtra të fragmenteve të muzikës popullore, këngëve për fëmijë ose muzikë nga filmat e animuar, ndërsa nxënësit e njohin se për çfarë lloj muzike bëhet fjalë dhe i klasifikojnë fragmentet në një kategori të përshtatshme.
- Nxënësit (individualisht ose në grupe) jua prezantojnë (duke kënduar ose me audio incizime) këngën e preferuar fëmijëve të tjerë dhe shpjegojnë shkurtimisht se pse është e preferuara e tyre.
- Mësimdhënësi iu paraqet nxënësve fragmente muzikore nga disa filma të animuar. Nxënësit grupohen rreth asaj që u pëlqen më shumë dhe shpjegojnë arsyen, përmes një shoqërimi emocional me muzikë (pikëlluese, ninullë, të hareshme, argëtuese, frikësuese).
- Mësimdhënësi paraqet incizime audio ose video të këngëve popullore që janë karakteristike për bashkësitë e ndryshme etnike që jetojnë në RMV (një për secilën). Nxënësit tregojnë se në cilën gjuhë interpretohet dhe mësimdhënësi e tregon përgjigjen e saktë duke shpjeguar shkurtimisht përmbajtjen e këngës.
- Bazuar në muzikën e dëgjuar më parë, mësimdhënësi prezanton incizime audio dhe video të pjesëve karakteristike të kompozimeve, ndërsa nxënësit e njohin se cila këngë ose kompozim është (loja “*Memoria muzikore*”).
- Mësimdhënësi prezanton (përmes incizimit ose këndimit) himnin kombëtar, ndërsa nxënësit qëndrojnë gjatë dëgjimit të tij dhe përmes diskutimit përcaktojnë se në cilat raste himni dëgjohet dhe këndohet.
- Mësimdhënësi përmes pikturave, lodrave etj., tregon kafshë të ndryshme (për shembull, breshkë, lepur, tigër, ari), ndërsa nxënësit imitojnë mënyrën dhe ritmin e lëvizjes (shpejt/ngadalë).
- Nxënësit luajnë lojën *ngrohtë/ftohtë* dhe pastaj konkludojnë mbi ndryshimet e forcës dhe shpejtësisë, të zbatuara gjatë lojës.
- Mësimdhënësi demonstroi dy kompozime të ndryshme me karakter të kundërt (këndon/perforon ose përmes incizimit audio), ndërsa nxënësit e përcaktojnë karakterin duke krahasuar tempin, dinamikën dhe kohëzgjatjen e toneve.
- Gjatë përzgjedhjes së muzikës për të dëgjuar ose kënduar, duhet menduar në përmbajtje shumëdisiplinore në lidhje me përmbajtjen e lëndëve të tjera (nxënësi dhe shkolla, stinët, festat dhe zakonet, vendlindja dhe atdheu, natyra dhe mjedisi, kafshët dhe bimët/lulet etj.)

<p>Tema: KËNDOJMË, PERFORMOJMË DHE LUAJMË</p> <p>Orët e përgjithshme: 18</p>	
<p>Rezultatet e mësimit</p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. këndojë këngë në mënyrë individuale dhe në grupe duke respektuar rregullat dhe teknikën e të kënduarit; 2. marrë pjesë në lojëra muzikore për fëmijë në këndim, vallëzim dhe performim në instrumente ritmike për fëmijë; 3. krijojë njësi të shkurtra ritmike dhe melodike dhe koreografi të thjeshta bazuar në frymëzimin muzikor. 	
<p>Përmbajtjet (dhe konceptet)</p>	<p>Standardet e vlerësimit</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Këngë dhe numërorë në vargun <i>re-la</i> (qëndrimi në këndim, frymëmarrja, kënga, melodia, teksti, kënga për fëmijë, kënga popullore, numërorët, këndimi solo dhe këndimi në grup). 	<ul style="list-style-type: none"> • Këndon një numër të caktuar këngësh për fëmijë dhe këngë popullore në vargun <i>re-la</i> me qëndrimin e duhur të këndimit dhe frymëmarrjen e duhur. • Këndon me të tjerët në një grup me temp, dinamikë dhe ritëm të harmonizuar.
<ul style="list-style-type: none"> • Instrumentet ritmike për fëmijë (shkopinj ritmikë, daulle, goditje, trekëndësh, çinele, dajre, daulle në madhësi të ndryshme, kastaneta, gong, ksilofon, maraka). 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh instrumentet e ritmit të fëmijëve nga ngjyra e tingullit. • Ndjek ritmin gjatë interpretimit të numërorëve dhe këngëve, duke prodhuar tinguj me goditje të bëra me dorë, objekte dhe instrumente të ritmit për fëmijë. • Zbaton si duhet komponentët e shprehjes muzikore (shpejtësia, vëllimi, kohëzgjatja) kur performon në instrumente të ritmit për fëmijë. • Ndjek ritmin duke trokitur (gjunjët, shpatullat, trupin).
<ul style="list-style-type: none"> • Lojëra muzikore (këndim, vallëzim modern, valle, marshim, vals). 	<ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë në lojëra muzikore duke kënduar dhe duke performuar në instrumente ritmike për fëmijë. • Ndjek llojin/ karakterin e muzikës me lëvizjet e tyre (vallëzim, marshim ose vals). • Këndon dhe lëviz në një ritëm të përshtatshëm në lojërat muzikore.
<ul style="list-style-type: none"> • Shprehja dhe krijimi muzikor. (shprehje e lirë muzikore, krijim). 	<ul style="list-style-type: none"> • Gërsheton melodinë dhe ritmin me lëvizjet. • Krijon njësi të shkurtra ritmike të shoqëruara me përplasje, ecje ose lloje të ndryshme të instrumenteve të ritmit për fëmijë. • Krijon koreografi të thjeshtë me hapa dhe lëvizje elementare me një karakter

të theksuar (të gëzuar ose të trishtuar), të përshtatshme për karakterin e muzikës.

Shembuj të aktiviteteve

- Nxënësit tregojnë numërorët që ata tashmë i njohin, pastaj bashkërisht me nxënësit e tjerë bëjnë përsëritje.
- Mësimdhënësi prezanton numërorë me tekste të ndryshme. Nxënësit përsërisin me diksion të qartë, artikulum të saktë dhe ritëm të saktë (aktiviteti përfshin një ushtrim në të cilin ritmi si zgjatje e rrokjeve të caktuara mund të ndryshojë).
- Mësimdhënësi prezanton qëndrimin e saktë të këndimit dhe frymëmarrjen e duhur, udhëzon nxënësit se si t'i zbatojnë ato drejt përmes ushtrimeve të ndryshme ("Fryni qiriun e ditëlindjes", "Luleradhiqja", "Supë e nxehtë"). Nxënësit i kryejnë ushtrimet dhe më pas këndojnë motive të shkurtra në një rrokje neutrale duke shfaqur sjelljen e duhur të këndimit dhe frymëmarrjen e duhur.
- Mësimdhënësi këndon/perforon ose lëshon incizime audio të këngëve për fëmijë dhe popullore me tempo dhe dinamikë të ndryshme në diapazonin e duhur (*re-la*), dhe më pas nxënësit i këndojnë këngët në grupe dhe individualisht.
- Nxënësit krijojnë instrument të thjeshtë të ritmit muzikor nga materialet në dispozicion (për shembull, trokëllitje me farat e frutave: nga një grusht oriz, thjerrëza, fasule, rërë, gurë më të imët dhe më të mëdhenj, gota/ shishe plastike, kavanozë qelqi me kapak, shirita gome, kartoni, kapakë metali).
- Kur interpretojnë lojëra muzikore me këndim, nxënësit shoqërohen nga instrumente ritmike për fëmijë (mundësisht me goditje të bëra me dorë), duke përplasur duart, gishtat, shpatullat, gjunjët, duke ndjekur ritmin.
- Mësimdhënësi lëshon një video ose audio incizim të vallëzimit, marshit dhe valsit duke demonstruar në të njëjtën kohë hapat e secilit prej tyre dhe duke përfshirë nxënësit në një aktivitet vallëzimi. Nxënësit krahasojnë ritmin, karakterin dhe performancën.
- Mësimdhënësi iu lëshon nxënësve një video ose audio incizim të valleve dhe këngëve popullore, karakteristike e bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë në RMV (nga një për secilin) dhe nxënësit i këndojnë dhe/ose performojnë në ritmin e duhur dhe ndjekin ritmin me ritmin e instrumenteve për fëmijë dhe trokitjen.
- Nxënësit këndojnë këngë paraprakisht të përpunuara dhe reagojnë spontanisht ndaj karakterit të muzikës përmes lëvizjeve spontane.
- Mësimdhënësi prezanton një shembull muzikor me një karakter marshimi në dy pjesë dhe nxënësit lëvizin përgjatë muzikës së dëgjuar (marshimi) duke numëruar një-dy, një-dy, duke ndjekur ritmin dhe tempon në drejtime të ndryshme sipas drejtimit të mësimdhënësit: majtas-djathtas, përpara-prapa.
- Mësimdhënësi prezanton një incizim audio dhe nxënësit duke përplasur duart ose duke trokitur në një karrige ose diçka të ngjashme e mbështesin ritmin.
- Nxënësit krijojnë ritëm dhe melodi të teksteve të shkurtra (mundësisht tekste që ata i kanë përpunuar në gjuhën e tyre amtare).
- Mësimdhënësi organizon punëtori krijuese në të cilat nxënësit së bashku me mësimdhënësin krijojnë koreografi për këngët sipas karakterit të muzikës dhe përmbajtjes së tekstit.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, NDËRKULTURA DHE INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi e siguron gjithëpërfshirjen duke i përfshirë të gjithë nxënësit në të gjitha aktivitetet gjatë orës. Në këtë mënyrë, ai mundëson që çdo fëmijë të jetë i angazhuar në mënyrë konjitive dhe emocionale përmes përdorimit të qasjeve të përshtatshme në mësimdhënie (individualizimi, diferencimi, puna në ekip, mbështetja mes nxënësve). Gjatë punës me nxënësit me aftësi të kufizuara, zbatohet një plan arsimor individual (me rezultate të përshtatura të të mësuarit dhe standarde të vlerësimit) dhe çdo herë kur është e mundur përdoret mbështetje shtesë nga individë të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, tutorë vullnetarë dhe profesionistë nga shkollat e qendrave të burimeve). Vëzhgon rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata të grupeve të ndjeshme, në mënyrë që të jenë në gjendje të identifikojnë vështirësitë e të mësuarit në kohën e duhur, për t'i inkurajuar dhe mbështetur ata në arritjen e rezultateve në mësimnxënie.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësimdhënësi trajton si djemtë ashtu edhe vajzat në mënyrë të barabartë, duke u kujdesur që të mos u caktojë atyre role stereotipike gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, bëhet një përpjekje për të siguruar ekuilibrin gjinor. Shembuj që promovojnë ndërkulturalizmin përdoren në përzgjedhjen e materialeve mësimore (për shembull këngët dhe folklori në gjuhët e bashkësive etnike).

Çdo herë kur është e mundur, mësimdhënësi përdor integrimin e aktiviteteve/ koncepteve të edukimit muzikor me përmbajtjen/ standardet e lëndëve të tjera në planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies. Në këtë mënyrë, kjo lëndë motivon nxënësit për të mësuar lëndë të tjera dhe ndihmon në zotërimin e tyre më të lehtë.

VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Për t'iu mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi vazhdimisht vëzhgon aktivitetet e tyre gjatë mësimdhënies dhe të mësuarit, gjithashtu mbledh informacione për përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin komente të cilat tregojnë nivelin e suksesit në realizimin e aktivitetit/detyrës dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Për atë qëllim mësimdhënësi vëzhgon dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose shokët/ shoqet e klasës;
- performancën praktike individuale (në këndim, në luajtjen e instrumenteve muzikore për fëmijë dhe lojëra muzikore);
- performancën praktike në një grup.

Pas përfundimit të mësimit të secilës temë, nxënësit marrin një notë përmbledhëse në formën e një përshkrimi të standardeve të arritura të vlerësimit. Vlerësimi përmbledhës kryhet si një kombinim i rezultatit të arritur në një test njohurish, në kombinim me vlerësimin e përparimit të konstatuar përmes teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti 2021/2022
Institucioni/ përfaqësuesi i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Në bazë të nenit 30 paragrafi (3) të Ligjit të Arsimit Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19 dhe 229/20) ministrja e Arsimit dhe e Shkencës miratoi programin mësimor për lëndën <i>Arsimi muzikor</i> për klasën I.	nr. _____ viti _____ <div style="text-align: right;"> Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës, Milla Carovska _____ </div>